



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.480/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit AAK-NISMA, me seli ne Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të bërjes së fushatës gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.02.2025, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.480/2025 e datës 09.02.2025, nga Koalicioni AAK-NISMA, me seli ne Prishtinë, e paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të bërjes së fushatës gjatë ditës së zgjedhjeve për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 09.02.2025, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga koalicioni AAK-NISMA, me të cilën pretendon se Më 09.02.2025, në ditën e zgjedhjeve, në fshatin Busi të Komunës së Prishtinës, në qendrën e votimit të Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët "Isa Boletini" 1952/01, janë parë një grup i njerëzve - përkrahës të subjektit politik të LVV në afërsi të kësaj qendre të votimit, siç mund të vërtetohet edhe nga fotot e bashkangjitura si provë. Parashtruesi i ankesës thekson se shihet nga fotografitë e bashkangjitura në ankesë se, pranë qendrës së votimit SHFMU "Isa Boletini" janë vendosur automjete që mbajnë banera ose fletushka me numrin 118 (numri i subjektit politik LVV) dhe sloganin e kësaj partie "Cep më Cep.". Sipas parashtruesit të ankesës se personat që kanë vendosur këto automjete pranë qendrës së votimit SHFMU "Isa Boletini" kanë ushtruar presion, duke mbledhur persona të tjerë me qëllim ndërhyrjeje në ushtrimin e së drejtës së votës.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 10.02.2025 subjekti politik LVV ka theksuar se automjeti dhe vetura si pjesë e provave të bashkëngjitura, përveçse janë jashtë rrethojave të Qendrës së Votimit, ashtu siç parashohin rregullat e miratuara nga KQZ, po ashtu nga të njëjtat nuk mund të vërtetohet se çfarë banera apo materiale propagandistike janë.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkëngjitur, që gjendet në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par. 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura në ankesë të cituara më lartë si dhe përgjigjes në ankesë, erdhi në përfundim se pretendimet e ankuesit në ankesën e tyre, se subjekti politik LVV ka bërë fushatë gjatë ditës së zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku ka vendosur automjete që mban banera ose fletushka me numrin 118 dhe sloganin e kësaj partie “Cep më Cep” në fshatin Busi të Komunës së Prishtinës në qendrën e votimit të Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët “Isa Boletini”-1952/01 PZAP-i i vlerëson si të pabazuara për faktin se nga fotografitë e ofruara në ankesë vërtetohet se automjetet janë jashtë rrethojave të Qendrës së Votimit dhe nuk mund të identifikohet se automjetet përmbajnë fletushka me numrin 118 si dhe sloganet “Cep më Cep”.

Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtuesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, për të provuar pretendimet ankimore. Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, Paneli konstaton se nga ana e Koalicionit AAK-NISMA, e cila ka parashtuar ankesën nuk mundë të pohohet me ndonjë provë materiale të shkeljes eventuale të dispozitave ligjore.

Prandaj, nga sa u tha më lartë ankesa vlerësohet si e pabazuar duke u bazuar në nenin 118, paragrafi 1, të LZP-së, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.480/2025 më datën 11.02.2025.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.